



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 19.3 të Ligjit për Teatrot nr.04/L-106, nenin 13.3 të Rregullores nr. 04/2015 (MKRS) për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe teatrove qyteteve, nenin 10 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-020/04-0011443/18 për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TEATRIN PUBLIK TË QYTETIT “AVDUSH HASANI” PODUJEVË

Neni 1

Teatri i qytetit “Avdush Hasani” Podujevë, për pjesëmarrje në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrove që do të mbahet në qytetin Bursa të Turqisë, mbështetet me mjete financiare, në shumë 1200.00 €.

Neni 2

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e Teatrit të Qytetit “Avdush Hasani”.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/04-0011804/18
Podujevë,
23 shkurt 2018



Kryetari i Komunës
Agim Veliu